



Financuar nga
Bashkimi Evropian

PROFILI I SHKURTËR GJINOR I KOSOVËS

NJË PËRMBLEDHJE E PËRDITËSUAR PËR TË INFORMUAR BE-NË PËR
PLANIN E ZBATIMIT NË NIVEL TË VENDIT TË KOSOVËS



PËRMBAJTJA

Hyrje.....	2
1. Liria nga të gjitha format e dhunës me bazë gjinore	2
2. Promovimi i shëndetit dhe të drejtave seksuale dhe riprodhuese.....	4
3. Promovimi i të Drejtave Ekonomike, Sociale që Fuqizojnë Vajzat, Gratë.....	5
Nxënësit në Arsimin Parafillor, Fillor dhe të Mesëm	5
Punësimi	7
Ndërmarrësia	7
4. Promovimi i Pjesëmarrjes dhe Lidershit të Barabartë	9
5. Integrimi i agjendës së grave, paqes dhe sigurisë.....	10
6. Tranzicioni dhe Digjitalizimi i Gjelbër.....	10
Mjedisi.....	10
Digjitalizimi.....	10


Zbatuar nga:



Plani i Veprimit Gjnor (PVGJ) III, “Një Agjendë Ambicioze për Barazinë Gjnore dhe Fuqizimin e Grave në Veprimin e Jashtëm të BE-së” 2021-2025, u miratua më 25 nëntor 2020, si [Komunikimi i përbashkët për Parlamentin dhe Këshillin Evropian](#) dhe një [Dokumenti i përbashkët i punës së stafit \(DPS\)](#). DPS përfshin një kornizë monitorimi dypjesëshe mbi 1) objektivat dhe treguesit institucionalë dhe strategjikë të BE-së; dhe 2) objektivat dhe treguesit për fushat tematike të angazhimit. Çdo delegacion i BE-së duhet të përgatisë një Plan të Zbatimit në nivel vendi (PZNV) për të udhëhequr zbatimin e PVGJ III, bazuar në analizën gjnore dhe konsultimet me palët kryesore të interesit. PZNV duhet të jetë në përputhje me programin tregues shumëvjeçar (PTSH), i cili në Kosovë ndërlihet me Instrumentin për Para-Anëtarësim (IPA) III dhe pesë dritaret e tij të financimit (Figura 1).

BE-ja ka një [Analizë gjnore të Kosovës](#) (2018), por disa të dhëna janë vjetërsuar dhe iu referohen objektivave dhe treguesve të [PVGJ II \(2016-2020\)](#). Kjo përmbledhje **synon** të sigurojë një analizë të përditësuar gjnore për të informuar BE-në për draftin e PZNV të PVGJ III të Kosovës në përputhje me PTSH, përkatësisht IPA III.¹ Kështu, analiza gjnore që vijon përfshin pjesë që përqendrohen në secilën nga gjashtë “fushat e angazhimit” në PVGJ III, duke i radhitur ato me pesë sektorët ose “dritaret” e IPA III (shih Figurën 1). Ajo përqendrohet në pabarazitë kryesore gjnore që ekzistojnë në Kosovë. Bazuar në këtë analizë, objektivat e mundshme të PVGJ III, mbi të cilat BE-ja mund të përqendrohet ose tashmë po përqendrohet sugjerohen për PZNV. Objektivat e PVGJ III të propozuara paraprakisht më poshtë përputhen me [Programin e Kosovës për Barazi Gjnore \(PKBGJ\) 2020-2024](#).

| Figura 1. Dritaret e Financimit IPA III në lidhje me Fushat Tematike të Angazhimit të PVGJ III



1. LIRIA NGA TË GJITHA FORMAT E DHUNËS ME BAZË GJNORE

Liria nga dhuna me bazë gjnore është e drejtë themelore dhe çështje e shtetit ligjor. Në vitin 2020, Kosova bëri ndryshimet në [Kushtetutën e saj për të përfshirë Konventën e Stambollit](#), dhe tani [Ligjin për Mbrojtjen nga Dhuna në Familje](#), [Ligjin për Shërbimet Sociale dhe Familjare](#), dhe [Strategjinë dhe Planin e Veprimit](#) relevant dhe [Procedurat Standarde të Operacionit \(PSO\)](#) të gjitha duhet të përditësohen për një përgjigje të përshtatshme shtetërore ndaj të gjitha formave të dhunës me bazë gjnore siç parashikohet nga Konventa. Një [ligj](#) dhe [PSO](#) ekzistojnë gjithashtu për adresimin e trafikimit seksual. [Kodi Penal](#) ka si vepër penale dhunën në familje, trafikimin seksual, përdhunimin, sulmin seksual, ngacmimin seksual, shkeljen e integritetit seksual dhe martesën e hershme për personat nën moshën 16 vjeç. Buxheti i shtetit kërkon përditësim për të siguruar financimin e duhur.


Dhuna mbetet e përhapur, kryesisht prek gratë dhe vajzat për shkak të normave gjnore të socializuara dhe marrëdhënieve të pushtetit.² Të dhënat e sondazhit tregojnë se 54% e grave në Kosovë kanë përjetuar një formë të dhunës së partnerit intim që nga moshën 15 vjeç: afërsisht 9% kishin përjetuar dhunë fizike,

¹ Përgatitur nga Donjeta Morina dhe Nicole Farnsworth nga Rrjeti i Grave të Kosovës (RrGK) për BE.

² Agjencia për Barazi Gjnore, [Programi i Kosovës për Barazi Gjnore](#), 2020.

53% dhunë psikologjike dhe 4% dhunë seksuale.³ Ngacmimi seksual është i përhapur, me 29% të grave që raportojnë se janë ngacmuar seksualisht që nga mosha 15 vjeç.⁴

Policia ka pranuar më shumë raporte të dhunës në familje në dekadën e fundit (Figura 2), gjë që nuk tregon domosdoshmërisht rritje të incidencës, por mund të sugjerojë përmirësim të besimit në polici.⁵ Katër gra u vranë nga partnerët e tyre në vitin 2018, dhe katër gra u vranë gjithashtu në vitin 2019.⁶ Në vitin 2019, policia hetoi 43 raste të trafikimit njerëzor që përfshiu 80 të dyshuar; 22 persona u arrestuan dhe tetë u dënuan me akuzë të trafikimit njerëzor në vitin 2019.⁷ Në total, 26 viktima të trafikimit u identifikuan në vitin 2019, kryesisht (19) viktima të trafikimit seksual.⁸ Në vitin 2020, policia pranoi 52 raste të raportuara të përdhunimit, 43 të sulmeve seksuale, 25 të ngacmimeve seksuale dhe dy të degradimit të integritetit seksual. Dhuna seksuale, si dhe format e tjera të dhunës me bazë gjinore, mbeten të nënraportuara për shkak të fajësimit të viktimave, frikës së stigmatizimit dhe “pajtitimit” midis viktimave dhe autorëve të krimit.⁹ Ndërsa ekzistojnë të dhëna shtetërore të martesave, të dhënat për martesat e hershme nën moshën 16 vjeç nuk janë të disponueshme. Martesa e hershme midis vajzave 16-17 vjeç duket e përhapur, shpesh të martuara me burra më të vjetër.¹⁰ Dëshmitë sugjerojnë që praktika është më e përhapur në zonat rurale dhe në mesin e komuniteteve romë, ashkali dhe egjiptianë.¹¹



Ndërsa ka përmirësim, përgjigjja institucionale ndaj dhunës me bazë gjinore mbetet e dobët, për shkak të raportimit të ulët; drejtësisë së vonuar; burimeve njerëzore të pamjaftueshme shtetërore për ndihmë dhe menaxhim të rasteve; një prirje e gabuar për të “pajtuar” viktimat dhe autorët; sisteme mosfunzionale për ndjekjen e çështjeve ndërinstucionale; dhe normat e shoqëruara si fajësimi i viktimave. Kosovës i mungojnë qendrat e referimit seksual, qendrat e krizave të përdhunimit dhe strehimore të mjaftueshme të qëndrueshme financiarisht.¹² Buxheti i pamjaftueshëm, burimet njerëzore dhe procedurat operacionale ekzistojnë për rehabilitimin dhe riintegrimin e duhur.

Tabela 1. Martesat midis moshës 16-17 vjeç, sipas gjinisë

Viti	Mosha	Burrë?	Grua
2017	16	0	15
	17	0	45
2018	16	0	3
	17	0	46
2019	16	0	6
	17	0	31

OBJEKTIVAT POTENCIALE PËR FUSHËN TEMATIKE 1 TË PVGJ III PËR KOSOVËN

- 1. Gratë, burrat, vajzat dhe djemtë, në të gjithë diversitetin e tyre, mbrohen më mirë nga të gjitha format e dhunës me bazë gjinore në sferën publike dhe private, në vendin e punës dhe në internet përmes legjislacionit dhe zbatimit efektiv, përmes Sundimit të Ligjit, UN Women dhe institucionit të shoqërisë civile (ISHC). (Ndërlidhet me Objektivin Specifik të PKBGJ 3.1.)
- 2. Gratë, burrat, vajzat dhe djemtë, në të gjithë diversitetin e tyre, janë agjentë të ndryshimit në lidhje me normat shoqërore diskriminuese, stereotipet gjinore dhe nxitësit gjinor të konfliktit përmes mbështetjes së shoqërisë civile. (Ndërlidhet me Objektivin Specifik të PKBGJ 3.1.)
- 3. Gratë, burrat, vajzat dhe djemtë, në të gjithë diversitetin e tyre, të cilët përjetojnë dhunë të bazuar në gjini kanë rritur qasjen në shërbimet thelbësore, përmes ndryshimeve ligjore të mbështetura nga BE dhe veprimeve të Sundimit të Ligjit. (Ndërlidhet me Objektivin Specifik të PKBGJ 3.1.)

³ OSBE, *Sondazh mbi mirëqenien dhe sigurinë e grave në Kosovë*, 2019.

⁴ Po aty.

⁵ RrGK, *Nga Ligjet në Vepra*.

⁶ Agjencia për Barazi Gjinore, *Programi i Kosovës për Barazi Gjinore*, 2020.

⁷ Departamenti i Shtetit i Shteteve të Bashkuara, *Raporti i Trafikimit Njerëzor 2020, Kosovë*.

⁸ Po aty.

⁹ RrGK, *Nga Ligjet në Vepra* dhe KIPRED, *Qasja në Drejtësi për Viktimat e Dhunës me Bazë Gjinore në Kosovë: Përfundimi i Mosdëshkimit për Kryerësit*, 2019.

¹⁰ Të dhënat e gjeneruara në Agjencinë e Statistikave të Kosovës (ASK), platforma “ASK Data”, e analizuar nga RrGK.

¹¹ Agjencia për Barazi Gjinore, *Programi i Kosovës për Barazi Gjinore*, 2020.

¹² RrGK, *Nga Ligjet në Vepra*.

- 5. Gratë, burrat, vajzat dhe djemtë në të gjithë diversitetin e tyre të trafikuar për të gjitha format e shfrytëzimit dhe abuzimit kanë përmirësuar qasjen në shërbime adekuate dhe cilësore për integrimin socio-ekonomik dhe mbështetjen psiko-sociale [e pasigurt nëse BE do të punojë në këtë] (Ndërlidhet me Objektivin Specifik të PKBGJ 3.1.)
- 7. Organizatat për të drejtat e grave, lëvizjet shoqërore dhe organizatat e tjera të shoqërisë civile janë me ndikim në dhënien fund të dhunës me bazë gjinore, siç mbështeten përmes dialogut politik dhe ISHC.
- 8. Të dhëna cilësore, të ndara dhe të krahasueshme globalisht për forma të ndryshme të dhunës me bazë gjinore dhe praktikat e dëmshme gjithnjë e më shumë mblidhen dhe përdoren për të informuar ligjet, politikat dhe programet, siç mbështetet nga Veprimi i Sundimit të Ligjit. (Ndërlidhet me Objektivin Specifik të PKBGJ 3.1.)



2. PROMOVIMI I SHËNDETIT DHE TË DREJTAVE SEKSUALE DHE RIPRODHUESE

Ndërsa IPA III nuk përqendrohet në mënyrë të qartë në shëndetësi, mbështetja financiare e BE-së e përkushtuar për lehtësimin e COVID-19 ndërlidhet. Padyshim, sipas qasjes së bazuar në të drejtat e theksuara në PVGJ III, e drejta për shëndetin seksual dhe riprodhues mund të ndërlidhet me të drejtat themelore dhe sundimin e ligjit. [Ligji për shëndetin riprodhues](#) rregullon aktivitetet duke përfshirë planifikimin e familjes, qasjen në informacion, sëmundjet seksualisht të transmetueshme, amësinë e sigurt dhe riprodhimin e asistuar. [Ligji për ndërprerjen e shtatzënisë](#) rregullon të drejtat e abortit, duke lejuar aborte të shkaktuara deri në javën e dhjetë të shtatzënisë pa një miratim të nënshkruar ose periudhë pritjeje. Disa faktorë kontribuojnë në një sistem të brishtë të kujdesit shëndetësor riprodhues, duke përfshirë një qasje joprofesionale të punonjësve shëndetësorë, mungesë të burimeve njerëzore, infrastrukturë të pamjaftueshme, praktika dhe norma kulturore dhe mungesë të vetëdijes.¹³ Ndërsa 95% e grave të moshës 15-49 njohin të paktën një metodë kontraceptive,¹⁴ njohuritë nuk lidhen domosdoshmërisht me përdorimin. Tërheqja mbetet metoda më e zakonshme e përdorur nga gratë e moshës 15-49 në një bashkëjetesë ose martesë (metoda kryesore e raportuar nga 49%), megjithëse 67% kanë përdorur kontraceptive moderne.¹⁵ Përqindja është pak më e ulët midis grave rome, ashkali dhe egjiptiane (62%). Vetëm 13% raportuan se nevojat e tyre për planifikim familjar ishin të kënaqura përmes metodave kontraceptive. Në përgjithësi, gratë dhe burrat në Kosovë nuk janë të informuar për HIV; vetëm 10% e burrave të rinj dhe 10.5% e grave të reja mund të identifikojnë se si transmetohet HIV dhe se njerëzit me pamje të shëndetshme mund të jenë HIV pozitivë.¹⁶ Është identifikuar një nevojë për kontrollë falas, në shkallë të gjerë për Virusin e Papatomës Njerëzore (HPV), por nuk është adresuar nga [Strategjia e Sektorit Shëndetësor](#).¹⁷

Kërkimet tregojnë se klinikat private kryejnë aborte të paligjshme pas javës së dhjetë të shtatzënisë, shumë prej të cilave punojnë pa licencë.¹⁸ Abortet selektive sipas gjinisë vazhdojnë, siç dëshmohet nga raporti i gjinisë në lindje (100 femra për 111,2 meshkuj), ndërsa mesatarja në botë është 100 femra për 105 meshkuj.¹⁹ Në përgjithësi, gratë dhe burrat përballen me disa kufizime në marrjen e kujdesit shëndetësor cilësor për shkak të mungesës së sigurimit shëndetësor, stigmës që lidhet veçanërisht me trajtimin psikologjik, trajtimet e padisponueshme dhe mbylljen e reparteve të maternitetit në zonat rurale. Gratë rurale, rome, ashkali, egjiptiane dhe gorane përballen me sfida të shtuara.²⁰ COVID-19 përkeqësoi çështjet e qasjes mes masave të izolimit.

OBJEKTIVAT POTENCIALE PËR FUSHËN TEMATIKE 2 TË PVGJ III PËR KOSOVËN

¹³ Agjencia për Barazi Gjinore, [Programi i Kosovës për Barazi Gjinore](#), 2020.

¹⁴ ASK, [Anketa Demografike e Shëndetit Social dhe Riprodhues në Kosovë](#), 2009.

¹⁵ KAS, [Anketa e Kllasterit të Treqesve të Shumëfishtë 2019/2020](#), 2020.

¹⁶ Po aty.

¹⁷ Agjencia për Barazi Gjinore, [Programi i Kosovës për Barazi Gjinore](#), 2020.

¹⁸ Banjska, Iliriana, [Abortet në Kosovë](#), 2019.

¹⁹ Po aty.

²⁰ RrGK, [Qasja në Shërbimin Shëndetësor në Kosovë](#), 2016.

- 1. Mjedisi i mundshëm ligjor, politik dhe shoqëror që lejon gratë dhe vajzat të kenë qasje dhe shërbime cilësore të shëndetit seksual dhe riprodhues (SHSR) dhe mbrojtjen e të drejtave të tyre seksuale dhe riprodhuese, përmes edukimit dhe dialogut politik. (Ndërlidhet me Objektivin Specifik të PKBGJ 2.3.)
- 2. Përmirësim i qasjes për çdo individ në kujdesin shëndetësor dhe shërbimet seksuale dhe riprodhuese, përfshirë shërbimet e planifikimit familjar, informacionin dhe edukimin mbi të drejtat seksuale dhe riprodhuese [?]. (Ndërlidhet me Objektivin Specifik të PKBGJ 2.3.)



3. PROMOVIMI I TË DREJTAVE EKONOMIKE, SOCIALE QË FUQIZOJNË VAJZAT, GRATË

NXËNËSIT NË ARSIMIN PARAFILLOR, FILLOR DHE TË MESËM

[Kushtetuta e Kosovës](#) garanton të drejtën për arsim publik falas për të gjithë. Disa ligje dhe politika rregullojnë qasjen në arsim gjithëpërfshirës dhe jo-diskriminues, përfshirë [Ligji për arsimin parashkollor](#), [Ligji për arsimin në komuna](#) të Republikës së Kosovës, [Ligji për arsimin parauniversitar](#), dhe [Ligji për Arsimin e Lartë](#).


DRAFT

Përkundër përmirësimeve, vajzat mbeten të nënpërfaqësuar në arsimin parashkollor (47%) dhe arsimin parafillor (48%).²² Arsyet përfshijnë mungesën e institucioneve parashkollore të përballueshme, rolet stereotipike gjinore dhe kuptimin e pamjaftueshëm të rëndësisë së arsimit parashkollor.²³ Kur përballen me burime të kufizuara, familjet mund të zgjedhin të dërgojnë djemtë e tyre e jo vajzat për shkak të normave mbizotëruese gjinore.²⁴ Në përgjithësi, frekuentimi parashkollor është i ulët. Kosova është larg përmbushjes së standardeve të BE-së “Arsimi dhe trajnimi 2020”, ku të paktën 95% e fëmijëve të moshës katër vjeç deri në arsimin e detyrueshëm duhet të ndjekin arsimin e fëmijërisë së hershme.²⁵ Vetëm katër fëmijë romë ndoqën arsimin parashkollor në 2018/2019 dhe asnjë fëmijë ashkali ose egjiptian.²⁶ Ndërsa vajzat dhe djemtë përfaqësohen proporcionalisht në shkollat fillore, të ulëta dhe të mesme të larta, ata studiojnë lëndë të ndryshme.

Tabela 2. Të dhëna të ndara gjinore mbi arsimin parauniversitar 2019-2020²¹

Niveli	Djem	Vajza	Totali
Parashkollor (0 <5)	53%	47%	4,164
Para-fillor (5-6)	52	48%	21,660
Fillore, e Mesme e Ulët	48.5%	51.5%	22,9338
Mesme e Lartë	49%	51%	74,427

Vajzat janë të nënpërfaqësuar në shkollat profesionale (42%) dhe djemtë janë të nënpërfaqësuar në gjimnaze 42%.²⁷ Rolet dhe stereotipet tradicionale gjinore mbi të cilat profesionet janë më të përshtatshme për gratë dhe burrat kontribuojnë në zgjedhjet arsimore.²⁸ Braktisja e shkollës së mesme të lartë është e ulët,²⁹ dhe djemtë përbënin 79% të braktisjeve në vitin akademik 2018/2019. Nuk ekziston ndonjë analizë e thelluar gjinore, por praktikuesit dhe ekspertët e arsimit deklarojnë se djemtë braktisin shkollën për të kërkuar punë në mes të presionit për të siguruar jetesën për familjet e tyre. Vajzat dhe djemtë nga përkatësia rome, ashkali dhe egjiptiane përfaqësohen proporcionalisht në arsimin fillor dhe të mesëm të ulët, por përqindja e vajzave që ndjekin shkollën e mesme të lartë bie në mënyrë drastike për të tri etnitë. Vajzat me nevoja të veçanta janë të nënpërfaqësuar në të gjitha nivelet e arsimit parauniversitar, veçanërisht në atë parashkollor (34% e fëmijëve me aftësi të kufizuara vijojnë) dhe shkollën fillore dhe të mesme të ulët (39%), dhe pak në shkollën e mesme të lartë gjithashtu (48%). Ndërsa analiza gjinore për qasje në arsim për fëmijët me nevoja të veçanta mungon, hulumtimi paraprak tregon se burimet e pamjaftueshme dhe normat gjinore mund të nënkuptojnë që prindërit i japin përparësi më shumë arsimit për djemtë e tyre sesa për vajzat e tyre. Vajzat dhe djemtë përballen me sfida për të ndjekur të gjitha nivelet e arsimit, duke përfshirë mungesën e materialeve të duhura për vështirësi në të mësuar, mungesën e infrastrukturës fizike, mungesën e ndihmësve personal, klasat e mbipopulluara, etj.³⁰



Mësuesit janë mjaft të nënpërfaqësuar në arsimin parashkollor. Në vitin akademik 2019/2020, vetëm një prej 553 mësimeve parashkollorë (0.2%) ishte

Tabela 3 Mësuesit parauniversitarë 2019-2020³¹

Niveli i shkollës	Burra	Gra	Totali
Parashkollor	0.2	99.8%	553
Para-fillor, Fillor dhe e Mesme e Ulët	40,6%	59.4%	17,426
Mesme e Lartë	56.9	43.1%	5,255

²¹ ASK, “Statistikat e Arsimit në Kosovë 2019/2020”.

²² Të dhënat krahasuar me regjistrimin e fundit të Kosovës, sipas të cilit 50.3% e popullsisë janë meshkuj dhe 49.6% femra.

²³ RrGK, *Kush kujdeset?*, 2016.

²⁴ Këshilli i Evropës, *Analiza gjinore ndër-sektoriale e arsimit parauniversitar*, 2020.

²⁵ *Konkluzione të Këshillit mbi një kornizë strategjike për Bashkëpunimin Evropian në Arsim dhe Trajnim*, 2019.

²⁶ Këshilli i Evropës, *Analiza gjinore ndër-sektoriale e arsimit parauniversitar*, 2020.

²⁷ ASK, “Statistikat e Arsimit në Kosovë 2019/2020”.

²⁸ Këshilli i Evropës, *Analiza gjinore ndër-sektoriale e arsimit parauniversitar*, 2020; dhe Helvetas, *Stereotipet gjinore dhe zgjedhjet arsimore në Kosovë*, 2019.

²⁹ Po aty, 1,382 raste në 2017/19 dhe 1,574 raste në 2018/2019. I njëjti burim për pjesën e mbetur të paragrafit.

³⁰ Farnsworth dhe të tjerët për USAID, *Vlerësimi gjinor, LGBTI dhe i personave me aftësi të kufizuara*, 2018.

³¹ ASK, “Statistikat e Arsimit në Kosovë 2019/2020”, 2020.

burrë.³² Burrat gjithashtu janë të nënpërfaqësuar në mesin e mësuesve të shkollës parafillore, fillore dhe të mesme të ulët, ndërsa gratë janë të nënpërfaqësuar në mesin e mësuesve të shkollës së mesme të lartë (43%). Shumica e librave shkollorë janë shkruar nga burra me konsultë minimale me ekspertë të barazisë gjinore.³³

Burrat janë të nënpërfaqësuar në universitetet publike në nivelin baçelor (40% në 2019/2020) dhe nivelet master. Gratë janë të nënpërfaqësuar vetëm në Akademinë e Kosovës për Siguri Publike. Nga 2,117 studentë në nivelin master, 64% janë gra. Më shumë gra gjithashtu diplomojnë nga baçelor (65% në 2018/2019) dhe nga studimet master (52%).³⁴ Në Kosovë, 96.9% e grave 15-49 vjeç dinë shkrim-lexim në krahasim me 98.5% të burrave.³⁵ Më konkretisht, 63.8% e grave rome, ashkali dhe egjiptiane të moshës 15-49 vjeç dinë shkrim-lexim, krahasuar me 81.4% të burrave.³⁶

PUNËSIMI

[Ligji i Punës](#) i Kosovës i ndalon të gjitha format e diskriminimit në punësim, rekrutim, trajnim, ngritje në detyrë, masa disiplinore dhe kushte të punësimit. [Ligji për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë](#) detyron punëdhënësit të sigurojnë trajtim të barabartë të të gjithë punonjësve në masat e sigurisë dhe shëndetit, veçanërisht të grave shtatzëna, grave që ushqejnë me gji dhe personave me aftësi të kufizuara.

Vetëm 40% e personave në moshë pune marrin pjesë në fuqinë punëtore (d.m.th., janë duke punuar ose në mënyrë aktive kërkojnë punë), 22% e grave dhe 59% e burrave.³⁸ Papunësia mbetet e lartë (25%), veçanërisht te gratë (33%). Gati 79% e grave janë joaktive në tregun e punës, krahasuar me 41% të burrave. Gratë priren të jenë joaktive për shkak të përgjegjësive të kujdesit në shtëpi, për fëmijët dhe të moshuarit, vetëm 1% e burrave përballen me këtë çështje.³⁹ Mesatarisht, gratë kalojnë 300% më shumë kohë në aktivitete të kujdesit të papaguar sesa burrat.⁴⁰ Transporti publik i pasigurt, i parregullt dhe/ose i padisponueshëm gjithashtu pengon gratë në zonat rurale të sigurojnë punësim.⁴¹ Diskriminimi i bazuar në gjini në punësim, veçanërisht i lidhur me [dispozitat e pushimit të lehonisë](#) ku bizneset paguajnë, dhe stereotipet e socializuara gjinore në profesion gjithashtu kontribuojnë në nivelet e ulëta të punësimit të grave.⁴² Ekonomia joformale mbetet e përhapur, por të dhëna të sakta të ndara sipas gjinisë nuk janë të disponueshme.

Treguesi	%	Burra	Gra	Të gjithë
Pjesëmarrjes në fuqi punëtore		58.9%	21.5%	40.0
Shkalla e joaktivitetit		41.1%	78.5%	60.0
Papunësia		21.0	33.1	24.6
Papunësia e të rinjve		37.4%	38.1%	37.7%
Rinia JPAT ³⁷		19.1%	12.5	17.5

NDËRMARRËSIA

Lloji	Përfituesit	Në pronësi të grave	Në pronësi të burrave	Shuma e marrë nga gratë	Shuma e marrë nga burrat	Totali
Mikro	18	1.6	17 (94%)	20,000 (6%)	338,350 (94%)	358,350
NVM-të	10	2:20	8 (80%)	60,000 (18%)	280,000 (82%)	340,000

³² Po aty.

³³ Agjencia për Barazi Gjinore, [Programi i Kosovës për Barazi Gjinore](#), 2020.

³⁴ ASK, ["Statistikat e Arsimit në Kosovë 2019/2020"](#), 2020.

³⁵ ASK, [Anketa e Kllasterit të Treguesve të Shumëfishtë 2019/2020](#), 2020.

³⁶ Po aty.

³⁷ Jo i punësuar, në arsim ose trajnim

³⁸ ASK, [Anketa e Tregut të Punës në Kosovë TM3 2020](#), 2021.

³⁹ RrGK, [Analiza Gjinore e Kosovës](#).

⁴⁰ Korporata e Sfidës së Mijëvjeçarit, [Raporti Hulmues i Studimit të Fuqisë Punëtore dhe Përdorimit të Kohës](#), 2018.

⁴¹ Agjencia për Barazi Gjinore, [Programi i Kosovës për Barazi Gjinore](#), 2020.

⁴² Po aty dhe RrGK, [Diskriminimi me bazë gjinore dhe puna në Kosovë](#), 2018.

Gratë janë të nënpërfaqësuar në bordet e	Total i	28	3:11	25 (89%)	80,000 (11%)	618,350 (89%)	698,350
--	---------	----	------	----------	--------------	---------------	---------

korporatave, që përbëjnë 10% të anëtarëve të bordit.⁴³ Nga 2,034 ndërmarrje aktive në Kosovë në vitin 2020, 20% ishin në pronësi të grave, 78% nga burrat dhe 2% së bashku.⁴⁴ Disa faktorë kontribuojnë në këtë, duke përfshirë mungesën e aftësive financiare dhe ndërmarrëse në mesin e grave, qasjen e kufizuar në financa dhe pronë dhe një perceptim stereotip që gratë nuk kanë aftësi për të menaxhuar bizneset.⁴⁵ Edhe duke e konsideruar këtë, subvencionet e Agjencisë për Investime dhe Përkrahjen e Ndërmarrjeve në Kosovë (KIESA) u takonin burrave në mënyrë disproporcionale më shumë sesa grave (Tabela 4).⁴⁶ Në raundin e parë të granteve (për makineri) në vitin 2020, gratë morën vetëm tri (13%) nga 24 grante dhe 16% të fondeve. KIESA nisi një grant specifik për ndërmarrjet në pronësi të grave për të adresuar efektet disproporcionale të COVID-19 mbi gratë.⁴⁷ Gratë morën të gjitha 25 grantet në raundin e dytë, në vlerë prej 320,079 €.

OBJEKTIVAT POTENCIALE PËR FUSHËN TEMATIKE 3 TË PVGJ III PËR KOSOVËN

- 1. Rritja e qasjes për gratë, në të gjithë diversitetin e tyre, për punë të denjë, përfshirë tranzicionin e grave në ekonominë formale dhe mbulimin nga sistemet e mbrojtjes sociale jodiskriminuese dhe gjithëpërfshirëse, përmes mbështetjes në punësim, asistencës sociale, komuniteteve dhe të tjera. (Përshtatur me Objektivin Specifik të PKBGJ 1.1).
- 2. Përmirësimi i politikës, kornizës ligjore dhe qasjes në shërbimet e kujdesit duke mundësuar ndarje të barabartë të punës së brendshme dhe të kujdesit midis grave dhe burrave, përmes dialogut politik dhe fondeve të arsimit. (Përshtatur me Objektivin Specifik të PKBGJ 1.2).
- 3. Rritja e qasjes për gratë në të gjithë diversitetin e tyre në shërbimet financiare dhe produktet, dhe burimet produktive, përmes konkurrencës dhe fondeve të lidhura me komunitetet. (Përshtatur me Objektivin Specifik të PKBGJ 1.2).
- 4. Gratë në të gjithë diversitetin e tyre kanë përmirësuar qasjen në mundësitë e ndërmarrjes, duke përfshirë ndërmarrjen sociale, jetesën alternative dhe pjesëmarrjen e forcuar në ekonominë e gjelbër dhe qarkore, përmes programimit të konkurrencës. (Përshtatur me Objektivin Specifik të PKBGJ 1.2).
- 5. Përmirësimi i qasjes për gratë në të gjithë diversitetin e tyre në rolet menaxheriale dhe udhëheqëse në sektorët socialë dhe ekonomikë, përmes programimit të konkurrencës. (Përshtatur me Objektivin Specifik të PKBGJ 1.2).
- 6. Ulja e pabarazive gjinore në regjistrim, progresion dhe mbajtje në të gjitha nivelet e arsimit dhe të mësuarit gjatë gjithë jetës për gratë, burrat, vajzat dhe djemtë, përmes programeve arsimore. (Përshtatur me Objektivin Specifik të PKBGJ 2.1).
- 7. Korniza rregullatorë e përmirësuar për të siguruar qasje të barabartë në shërbime të kujdesit fizik dhe shëndetësor parandalues, kurativ dhe rehabilitues të shëndetit fizik dhe mendor për gratë, burrat, vajzat dhe djemtë, me të gjithë diversitetin e tyre, përfshirë situatat e krizës, përmes dialogut politik [?]. (Përshtatur me Objektivin Specifik të PKBGJ 2.1).
- 8. Përmirësimi i qasjes në ujë të sigurt dhe kanalizime, të ndara së paku sipas gjinisë. (Përshtatur me Objektivin Specifik të PKBGJ 2.1).
- 9. Sistemet e shëndetit publik kanë financim të mjaftueshëm dhe të qëndrueshëm për të adresuar nevojat shëndetësore të grave dhe vajzave në të gjithë diversitetin e tyre [?]. (Përshtatur me Objektivin Specifik të PKBGJ 2.1).

⁴³ Qendra për Studime Gjinore në Kosovë, [Kuota Gjinore në Bordet e Korporatave në Kosovë](#), 2019.

⁴⁴ ASK, [Repertori Statistikor i Ndërmarrjeve Ekonomike në Kosovë TM2](#), 2020.

⁴⁵ Agjencia për Barazi Gjinore, [Programi i Kosovës për Barazi Gjinore](#), 2020.

⁴⁶ Të dhëna nga KIESA, prill 2021.

⁴⁷ Isufi, Antigona, ["Miratohet Kodi për mbështetjen e bizneseve të grave në Kosovë"](#) [Në shqip], *Kallxo*, 30 korrik 2020.



4. PROMOVIMI I PJESËMARRJES DHE LIDERSHIPIT TË BARABARTË

Pjesëmarrja e barabartë e grave në vendimmarrje është një e drejtë themelore, e mbrojtur nga [Ligji për Barazi Gjinore](#); lidhet gjithashtu me demokracinë, qeverisjen e mirë, marrëdhëniet fqinjësore, bashkëpunimin ndërkuftar dhe të gjitha dritaret e financimit të IPA III. Në të gjitha zgjedhjet qendrore dhe komunale që nga viti 2013, gratë kanë përbërë më pak se 40% të votuesve (Figura 3). Gratë mbeten të nënpërfaqësura në Komisionet Komunale të Zgjedhjeve, Komisionin e Qendrës së Votimit dhe Komisionin Qendror të Zgjedhjeve.⁴⁸ Gjithnjë e më shumë gra po zgjidhen në parlament pa kuotën gjinore (Figura 4). Sidoqoftë, përkundër përmirësimeve, gratë mbeten





Tabela 6 Ministrat sipas Gjinisë

Viti	Gra	Burra	Totali
2011 - 2014	12%	88%	17
2014-2017	11%	89%	19
2017-2019	10%	90%	21
2020 (Kurti)	33%	67%	15
2020 (Hoti)	19%	81%	16
2021	33%	67%	15

të nënpërfaqësura në pozitën udhëheqëse. Asnjë grua nuk ka qenë kurrë Kryeministre, dhe gratë kanë qenë të nënpërfaqësura si ministre (Tabela 6) dhe zëvendësministre (vetëm 20% që nga viti 2008). Përveç kryesimit, gratë janë lënë kryesisht jashtë dialogut me Serbinë, si eksperte dhe në konsultime publike. Gratë përbëjnë 44% të nëpunësve civilë në nivelin qendror dhe 33% në nivelin komunal. Gratë kanë tendencë të nënpërfaqësohen në nivelet e vendimmarrjes. Edhe pse është [një detyrim ligjor](#), Kosova ende nuk e ka institucionalizuar plotësisht buxhetimin e përgjegjshëm gjinor.⁴⁹ Të dhënat për pjesëmarrjen e grave dhe burrave në konsultat publike nuk janë të disponueshme. Ndërsa dëshmitë tregojnë se ato janë nxitësit kryesorë të ndryshimeve shoqërore, organizatat e shoqërisë civile për të drejtat e grave (OSHC) përballen me sfida për të hyrë në fonde të qëndrueshme; 86% raportojnë se kanë mungesë burimesh dhe 16% nuk kanë pasur kurrë financim.⁵⁰ Megjithatë ato ofrojnë shërbime thelbësore shtetërore, strehimoret është dashur të mbyllen periodikisht për shkak të boshllëqeve të financimit. Gratë mbrojtëse të të drejtave të njeriut periodikisht përballen me fushata shpifjesh dhe kërcënimesh.

OBJEKTIVAT POTENCIALE PËR FUSHËN TEMATIKE 4 TË PVGJ III PËR KOSOVËN

- 1. Mundësimi i kushteve të krijuara për pjesëmarrje të barabartë të grave, burrave, vajzave dhe djemve, në të gjithë diversitetin e tyre, në vendimmarrje, përmes dialogut politik dhe ISHC. (Përshtatur me Objektivin 3.2 të PKBGJ.)
- 2. Gratë dhe vajzat, në të gjithë diversitetin e tyre, kanë përmirësuar qasjen në drejtësi për të mbrojtur të drejtat e tyre civile dhe politike, përmes sundimit të ligjit dhe programeve të ISHC. (Përshtatur me Objektivin 3.2 të PKBGJ.)
- 3. Organizatat e grave, OSHC-të e tjera dhe gratë mbrojtëse të të drejtave të njeriut që punojnë për barazinë gjinore dhe fuqizimin dhe të drejtat e grave dhe vajzave punojnë më lirshëm dhe mbrohen më mirë nga ligji, përmes dialogut politik dhe ISHC. (Përshtatur me Objektivin 3.2 të PKBGJ.)
- 4. Norma, qëndrime dhe sjellje të barabarta shoqërore që promovojnë pjesëmarrje dhe udhëheqje të barabartë të nxitur në nivelet e komunitetit dhe individëve përmes edukimit qytetar, medias, arsimit dhe kulturës në të gjitha nivelet, përmes dialogut politik, komunikimit, programeve arsimore dhe ISHC. (Përshtatur me Objektivin 3.2 të PKBGJ.)

⁴⁸ Agjencia për Barazi Gjinore, [Programi i Kosovës për Barazi Gjinore](#), 2020.

⁴⁹ Për më shumë shih RrGK, "[Monitorimi i zbatimit të indikatorit 5.c.1 \(Buxhetimit Gjinor\) të SDG-ve në Kosovë](#)", 2020.

⁵⁰ RrGK, [Ku janë paratë për të drejtat e grave? Trendet e Financimit në Ballkanin Perëndimor](#), Fondacioni Kvinna till Kvinna, 2020.



5. INTEGRIMI I AGJENDËS SË GRAVE, PAQES DHE SIGURISË

Gjatë luftës, gratë mbështetën zgjidhjen e konflikteve; ofruan arsim, ndihmë humanitare dhe kujdes shëndetësor; dokumentuan shkelje të të drejtave të njeriut; dhe mbajtën demonstrata duke kërkuar paqen.⁵¹ Pas luftës, gratë u morën me ndërtimin e paqes përmes politikës, ndërtimit ndëretnik të paqes, rrjeteve dhe adresimit të dhunës. Pavarësisht kontributeve të tyre, gratë u lanë jashtë negociatave me Serbinë, kështu që ato organizuan bisedime paralele dhe aktivitete për të dëgjuar zërin e tyre. Dialogu Kosovë-Serbi u drejtua nga një grua 2011-2017, por prioritetet e grave si personat e zhdukur, drejtësia për të mbijetuarit e dhunës seksuale, kthimi i kursimeve të sigurimeve shoqërore dhe dëmshpërblimet nuk u adresuan. Ndërmjetësuesit ndërkombëtarë të paqes kanë dështuar rregullisht të takojnë gratë dhe të dëgjojnë shqetësimet e tyre. Megjithatë ka pasur përmirësime, gratë gjithashtu kanë mbetur të nënprefaqësuar në misionet e huaja, duke përbërë 26% të 1,071 zyrtarëve në misionet e huaja nga 2008 në 2019. Ndërsa një ligj siguron disa përfitime për të mbijetuarit e dhunës seksuale të kryer gjatë luftës që nga viti 2014, nuk ka pasur dëmshpërblime zyrtare dhe mbizotëron pandëshkueshmëria. Përpjekjet për ndihmë dhe rimëkëmbje fillimisht nuk adresuan gjithmonë nevojat e ndryshme të grave. Ndërsa integrimi gjinor i një programi të tillë është përmirësuar me kalimin e kohës, të dhënat e ndara sipas gjinisë për përfituesit aktualë mbeten të kufizuara.

OBJEKTIVAT POTENCIALE PËR FUSHËN TEMATIKE 5 TË PVGJ III PËR KOSOVËN

Meqenëse Kosova është një vend pas konfliktit, të gjitha objektivat janë të rëndësishme: 1) Pjesëmarrja, 2) Integrimi Gjinor, 3) Udhëheqja me Shembull, 4) Parandalimi, 5) Mbrojtja, 6) Ndihma dhe Rimëkëmbja. Kjo do të harmonizohet me Objektivin Specifik të PKBGJ 3.3: “Rritja e pjesëmarrjes së grave në proceset e negociatave, paqes dhe pajtimit, në misionet diplomatike dhe misionet jashtë vendit”, ndër të tjera.



6. TRANZICIONI DHE DIGJITALIZIMI I GJELBËR

MJEDISI


Ekziston një analizë e kufizuar gjinore e thelluar në lidhje me ndryshimin e klimës dhe mjedisin. Kosovës i mungon një sistem monitorimi, raportimi dhe verifikimi që përfshin detyrimet për të raportuar për gjininë, sipas PVGJ III. Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPH) kreu analiza paraprake gjinore, por këto nuk duket se janë përditësuar.⁵² Gratë në MMPH mbeten të nënprefaqësuar, veçanërisht në pozitat e vendimmarrjes.⁵³

Tabela 7. Të dhënat e ndara gjinore për punonjësit e MMPH-së

Viti	Totali	Gra	Burra	Gra në vendimmarrje	Burra në vendimmarrje
2018	251	37.8%	62.2%	34.8%	65.2%
2019	248	37.1%	62.9%	36%	64
2020	249	40.5%	59.4	34%	66%

DIGJITALIZIMI

Numri i familjeve me qasje në internet është rritur nga 93% në vitin 2019 në 96% në vitin 2020.⁵⁴ Burrat vazhdimisht kanë pasur qasje më të mirë në internet. Në vitin 2020, 57% e burrave raportuan përdorimin e internetit në shtëpi,



⁵¹ RrGK, *Një Vend në Tryezë*, së shpejti në vitin 2021. I gjithë paragrafi bazuar në këtë raport.

⁵² MMPH, *Analiza Gjinore Institucionale*, 2017. RrGK, *Buxhetimi për një mjedis më të mirë*, 2016 dhe një tjetër në 2017. MMPH do të dërgojë të dhëna të azhuruara për konsultimet publike, përfaqësimin institucional dhe pjesëmarrjen në trajnime.

⁵³ Të dhënat e marra nga MMPH, prill 2021.

⁵⁴ ASK, *Anketë mbi përdorimin e teknologjisë së informacionit dhe komunikimit*, 2020.

krahasuar me 40% të grave.⁵⁵ Gratë duken të nënpërfaqësuar në sektorin e Teknologjisë së Komunikimit në Internet (TKI); vetëm 22% e punonjësve të sektorit ishin gra në vitin 2014, dhe të dhëna më të reja nuk janë në dispozicion.⁵⁶ Më pak gra të reja sesa burrat diplomojnë në drejtimet e ndërlidhura me TKI në Universitetin e Prishtinës.⁵⁷

OBJEKTIVAT POTENCIALE PËR FUSHËN TEMATIKE 6 TË PVGJ III PËR KOSOVËN

- 1. Rritja e pjesëmarrjes së grave dhe vajzave në të gjithë diversitetin e tyre në proceset e vendimmarrjes për mjedisin dhe çështjet e ndryshimit të klimës, përmes të gjithë programimit dhe dialogut politik në lidhje me mjedisin.
- 2. Strategjitë dhe marrëveshjet për zbutjen e klimës, përshtatjen, zvogëlimin e rrezikut nga katastrofat dhe menaxhimin e qëndrueshëm të burimeve natyrore dhe biodiversitetit janë më të përgjegjshme ndaj gjinisë, përmes programimit të mjedisit dhe dialogut politik.
- 3. Gratë, burrat, vajzat dhe djemtë, në të gjithë diversitetin e tyre, adresimi i ndryshimeve klimatike në jetën e tyre të përditshme dhe ruajtja e mjedisit natyror njihen dhe vlerësohen, përmes programimit të mjedisit dhe mbështetjes së shoqërisë civile, përfshirë programet rajonale.
- 4. Gratë dhe burrat në të gjithë diversitetin e tyre, gjithnjë e më shumë marrin pjesë dhe kanë përmirësuar qasjen në punë, mundësi ndërmarrëse dhe mjete jetese alternative në ekonominë e gjelbër dhe ekonominë qarkore, përmes programit të mjedisit dhe konkurrencës.
- 5. Gratë, burrat, vajzat dhe djemtë, në të gjithë diversitetin e tyre, marrin pjesë në mënyrë të barabartë në politikat dhe vendimmarrjet për botën digjitale, në nivelet lokale, kombëtare, rajonale dhe ndërkombëtare dhe përfaqësohen në këto politika dhe vendime, përmes tranzicionit digjital dhe programimit të arsimit.
- 6. Gratë, burrat, vajzat dhe djemtë në të gjithë diversitetin e tyre kanë qasje të barabartë në brezin e gjerë, teknologjinë dhe mjetet digjitale të përballueshme dhe të sigurta [?].
- 7. Gratë, burrat, vajzat dhe djemtë sigurohen në mënyrë të barabartë dhe përdorin njësoj shkrim-lexim publik digjital [?].
- 8. Gratë, burrat, vajzat dhe djemtë, në të gjithë diversitetin e tyre, marrin pjesë plotësisht dhe në mënyrë të barabartë në ekonominë digjitale, përmes programimit të ekonomisë qarkore.

⁵⁵ Po aty.

⁵⁶ STIKK, "[Gratë në Teknologji](#)", Dokumenti i Pozicionit, 2014.

⁵⁷ Fondacioni i Mijëvjeçarit Kosovë, "[Të dhënat e të diplomuarve](#)", 2019, qasur në Prill 2021. Shikoni grafikun e dytë.